



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

PROKURORIA THEMELORE

Zyra e Kryeprokurorit

AD.nr.3/2025

Më datë: 12 Mars 2025

Gjilan

Në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan si autoritet kompetent, merr këtë:

V E N D I M

HUDHET, ankesa e paraqitur nga pala ankuese [REDACTED] për shkelje disiplinore nga prokurorja e shtetit [REDACTED] – prokurore në Prokurorinë Themelore në Gjilan/Departamenti për Krime të Rënda.

A r s y e t i m i

Më datë 06 Mars 2025, nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kemi pranuar ankesën e palës ankuese [REDACTED] me pretendim të sjelljeve jo etike nga prokurorja e shtetit [REDACTED] – prokurore në Prokurorinë Themelore në Gjilan/Departamenti për Krime të Rënda, gjatë shqyrtimit gjyqësor në rastin me nr. [REDACTED]

Më datë 11 Mars 2025, konform nenit 9 par. 5 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, është njoftuar Këshilli Prokurorial i Kosovës, për pranimin e ankesës nga pala ankuese [REDACTED]

Pala ankuese [REDACTED] në ankesë ka pretenduar se prokurorja e shtetit [REDACTED] gjatë përfaqësimit të rastit me nr. [REDACTED] në Gjykatën Themelore në Gjilan, me datën 05.02.2025 ka pasur sjellje jo etike.

Më tutje, i njëjti pretendon se veprimet e prokurores kanë ndikuar negativisht në procesin gjyqësor, si në integritetin e tij moral, ashtu edhe në pikëpamje shëndetësore, pasi sipas tij fjalët e prokurores së shtetit tek i njëjti kanë krijuar stres dhe depresion dhe ishte detyruar që të merrte

ndihmë mjekësore fillimisht në QKMF, në Gjilan, e pastaj në Spitalin e Përgjithshëm në Emergjencë, në Mitrovicë.

Pas pranimit dhe analizimit të ankesës së paraqitur nga pala ankuese [REDAKTUAR], me qëllim të verifikimit të këtij dyshimi, kemi kërkuar rastin me numër [REDAKTUAR], në të cilin janë analizuar edhe procesverbalet gjatë shqyrtimeve gjyqësore në Gjykatën Themelore në Gjilan, të përfaqësuar prokurorja e shtetit [REDAKTUAR].

Gjithashtu, nga prokurorja e shtetit është kërkuar shënim zyrtar lidhur me këtë çështje, ku pas vlerësimit kemi konstatuar gjendjen e poshtëshënuar.

Prokurorja e shtetit [REDAKTUAR], ka përfaqësuar aktakuzën me nr. [REDAKTUAR] të datës 23.05.2017, të ushtruar nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, ndaj [REDAKTUAR] nga Mitrovica, për shkak të dy veprave penale "Fajdeja", nga neni 343 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 05.02.2025, në Gjykatën Themelore në Gjilan, mbrojtësi i të akuzuarit [REDAKTUAR], av. [REDAKTUAR] ka kërkuar përjashtimin e prokurores së shtetit [REDAKTUAR], kinse për shkak të reagimeve- paragjytimeve se klientin e tij e ka quajtur fajdexhi, ku lidhur me këtë prokurorja e shtetit [REDAKTUAR], sipas procesverbalit të datës 05.02.2025, pas kërkesës për përjashtim ka deklaruar se nuk ka bazë nga përjashtimi i aktakuzës së PTH në Mitrovicë, e që sipas së cilës i akuzuari [REDAKTUAR] është i akuzuar për dy vepra penale të fajdes, e në anën tjetër kërkon nga gjykata që të mos i ceket në ftesë epiteti i të akuzuarit, ku lidhur me këtë prokurorja e shtetit ka potencuar se kurrfarë epiteti nuk i ka vënë të akuzuarit, përpos asaj që i është vënë në barrë sipas aktakuzës dhe se kurrfarë arsye personale nuk ka me të akuzuarin.

Lidhur me pretendimet rreth fjalëve fyese nga ana e prokurores së shtetit ndaj palës ankuese, theksojmë se e njëjta në shënim zyrtar ka potencuar se kishte cituar fjalët e dëshmitarit [REDAKTUAR], i cili në seancën gjyqësore të mbajtur me datë 27.12.2023, në Gjykatën Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda, ndër të tjera kishte deklaruar se: të akuzuarin [REDAKTUAR] e njoh si njeri që merret vetëm me fajde që 11 vjet, për këtë e din e gjithë Mitrovica, pasi që qyteti është i vogël edhe të gjithë njihen njëri me tjetrin.

Gjithashtu, edhe i dëmtuari [REDAKTUAR] në të gjitha deklaratat e dhëna në polici, prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 28.02.2025, ka deklaruar se nga [REDAKTUAR] ka marr dy herë para me fajde.

Prokuroria e shtetit, në shënim zyrtar ka theksuar se nga aktakuza me nr. [REDAKTUAR] e ngritur më datë 23.05.2017, nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, e cila është transferuar në Prokurorinë Themelore në Gjilan, disa vepra penale janë parashkruar për arsye të ndryshme – zvarritje dhe e njëjta lëndë nuk është përfunduar dhe ka konsideruar që përjashtimi i saj është një tentativë për zvarritje të mëtutjeshme e lëndës.

Pas analizimit dhe vlerësimit të kësaj ankese, konsiderojmë se në veprimet e prokurores së shtetit [REDACTED] nuk është identifikuar asnjë shkelje disiplinore gjatë përfaqësimit të saj në Gjykatën Themelore në Gjiilan.

Andaj bazuar në dispozitat ligjore dhe arsyet faktike të cilat u cekën më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KRYEPROKURORI

Arbën Kadriu

Kopje/njoftim konform nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve:

- 1x1 kopje z. Ardian Hajdaraj, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- 1x1 kopje, [REDACTED];
- 1x1 kopje, arkivës.